REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:063902
Datë: 18.05.2023
Numri i dokumentit: 04296109

PKR.nr.2023:040341

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti për Krime të Rënda, **gjyqtari Sulltan Dobraj – kryetar i trupit gjykues,** me Sekretaren juridike Nushe Kadrija, në çështjen penale kundër të akuzuarit **P.G** nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale te sulmit nga neni 187 prg.1 të KPRK-së, si dhe te akuzuarit **I. B.** nga fshati ... Komuna Gjakovës, për shkak të vepër penale mbajtja ne pronësi, kontrolle ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 prg.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës, PP/I.nr.1494/2018 të datës 15.09.2022, të ushtruar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 03.05.2023, me pjesëmarrjen e Prokurorit te Shtetit Dëshire Jusaj, të akuzuarit **P.G** dhe mbrojtëses së tij Av.Mone Syla, të akuzuarit **I. B.** dhe mbajtëses së tij, Av. Feride Xani e caktuar sipas detyrës zyrtare, me datë 04.05.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 18.05.2023 përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

Ndaj të akuzuarve

I. **P.G**, nga i ati ... dhe e ëma ... e gjinisë ..., data e lindjes.. në fshatin ...e, Komuna e Gjakovës, ku edhe banon, identifikohet me numër personal ..., i martuar,i pa pune i gjendjes se dobët ekonomike,shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

II. **I.B,** nga fshati ... K. Gjakovës i biri i ... dhe i ... e gjinisë Krasniqi, data e lindjes... në fshatin ... Komuna Gjakovës, ku edhe banon, identifikohet me numër personal ..., i martuar, bukëpjekës, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

2020:115469

J A N Ë F A J T O R

I pandehuri: P.G
Për shkak se:

Me dt**.**19.04.2018 rreth orës 20:00min,ne fsh... K. Gjakovës, e përdor forcën fizike pa pëlqimin e te dëmtuarit/pandehurit I.B nga fsh... K. Gjakovës, në atë mënyrë qe derisa ishte i ndalur ne rruge me automjetin e tije i dëmtuari/pandehuri pas tij me automjet i bie burisë qe t`ja liroj rrugën, i pandehurit P me te shpejt del nga automjeti dhe e sulmon fizikisht ta godas por nuk arrin ndërsa i dëmtuarit/pandehurit qe te frikësojë nxjerr revolen e me te shtinë ne ajër dhe i ndërprenë sulmin.

–**me çka ka kryer vepër penale te sulmit nga neni 187 prg.1 te KPRK**

I pandehuri: I.B

II. Pasi qe me pare ka siguruar e gjere me dt. 19.04.2018 rreth orës 20.00min ne fsh... K. Gjakovës, pa autorizim ka mbajtur arme e municion ne kundërshtim me nenin 4 prg.1 nen.prg1.1 te ligjit për arme R.Kosoves,te cilat me ligj kategorizohen si arme zjarri te ndaluara, dhe ate:1(një) Pistolete F.B. ..., modeli 35.Par,me nr. Serik ... kal.9mm,me (nje) karikator dhe 3 (tre) fishek, ashtu qe gjate fjalosjes me te pandehurin P.G nga fsh.... K. Gjakove, që te frikësoj nxjerr armen e me te shtëna ne ajërte pas një raportimi arma i është gjetur me karikator dhe gëzhoja, e i është sekuestruar e gjenden ne dhomën e dëshmive ne Stacionin policor ne Gjakove.

- me çka ka kryer vepër penale ,mbajtja ne pronësi, kontrolle ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 prg.1 te KPRK-se.

Andaj gjykata në bazë të nenit 7, 17, 41, 46, 49, 50, 51, 52, 53, 58, 73, 74, 187 par.1, 374 par.1 lidhru me par.3 të KPK; neneve 358, 359, 360, 361, 364, 452, 462, të KPPK-së, të akuzuarit i :

I GJYKON

ME DËNIM ME KUSHT ME URDHËR PËR MBIKQYRJE NGA SHËRBIM SPROVUES

I. Të akuzuarit P.G për veprën penale në pikën I të dispozitivit i përcakton dhe i shqipton dënimin me burgim ne kohezgjatje prej 6 (gjashte)muajve,I cili denim nuk do te ekzekutohet nëse I dënuari nuk kryen vepër tjetër ne afate prej 1(një)viti duke filluar nga dita kur ky aktgjykim te merr formën e prerë

II. Të akuzuarit P.G për veprën penale në pikën I të dispozitivit i përcakton dhe i shqipton dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 6 (gjashte)muajve, I cili dënim nuk do te

2020:115469

ekzekutohet nëse I dënuari nuk kryen vepër tjetër ne afate prej 1(një)viti duke filluar nga dita kur ky aktgjykim te merr formën e prerë.

III. Gjykata mund ta revokon dënimin me kusht me burgim për secilin të dënuar nëse të dënuarit gjatë kohës së verifikimit kryejnë një apo më shumë vepra penale.

IV. Konfiskohet arma: arma e llojit MP-57 me karikator–disk me numër serik 1600575 të datës 19.04.2023, si objekt i kryerjes së veprës penale.

V. Urdhërohen te dënuarit qe te mbajnë kontakt me shërbimin sprovues, njoftohen te dënuarit se nëse nuk mbajnë kontaktin me shërbimin sprovues Gjykata mund te revokon dënimin me kusht.

VI.

VII. OBLIGOHEN të akuzuarit P.G dhe I.B që t'i paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor se cili veç e veç në shumën prej nga 30 (tridhjetë) euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç shumën prej nga 50 (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 30 (tridhjete) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykim.

Arsyetim

PTH ne Gjakovë me aktakuzën**,** PP/I.nr.1494/2018 të datës 15.09.2022, ka akuzuar, **P.G** nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale te sulmit nga neni 187 prg.1 të KPRK-së, si dhe te akuzuarit **I.B** nga fshati ... Komuna Gjakovës, për shkak të vepër penale mbajtja ne pronësi, kontrolle ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 prg.1 të KPRK-së,ka propozuar të caktohet shqyrtimi gjyqësor kundër të njëjtit, të administrohen provat e duhura e me në fund i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata Themelore në Gjakovë, me dt.03.05.2023, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor ku pas leximit te aktakuzës te pandehurit secili e ka pranuar fajësinë, për veprën për te cilën ishte akuzuar, te cilin pranim fajësie gjykata e ka pranuar me aktvendim në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor konform nenit 242 lidhur me nenin 322 te KPPK-ës.

Prokurorja në fjalën përfundimtare deklaroi se: me vet faktin e pranimin e fajësisë së dy të akuzuarve në këtë seancë gjyqësore me vet faktin se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë u vërtetua se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale të përshkruare si në dispozitiv të aktakuzës, dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të dy akuzuarve argumentoi në tërësi besueshmërinë e aktakuzës e cila ka mbështetje edhe në shkesat tjera që gjenden në lëndë dhe në lidhshmëri të gj itha së bashku bëjnë që të vim në përfundim që vërtetë të akuzuarit kanë kryer veprat penale të cilat i kanë kryer dhe propozon gjykatës që të njëjtit ti shpallë fajtor ti dënoi sipas ligjit, sa i përket rrethanave lehtësuese gjykata të ketë parasysh pranimin e fajësisë e sa i përket rrethanave rënduese gjykatës ja le në vlerësim nëse gjen ndonjë rrethanë të tillë dhe nuk kërkoi caktim të seancës për caktimin e dënimit.

I.B në cilësinë e të dëmtuarit ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike por ka një lutje që ky rast të jetë i fundit në mes tyre.

2020:115469

P.G në cilësinë e të dëmtuarit ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike por ka një lutje që ky rast të jetë i fundit në mes tyre.

Avokatja Mone Syla në fjalën e saj përfundimtare deklaron se meqenëse i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë pas konsultimeve të mjaftueshme lidhur me rastin për të cilën i akuzuari im pandehet, e që i njëjti lidhur me këtë rast deklaron se këtij incidenti të ditës kritike ka ndodhur aksidentalisht dhe i propozon gjykatës si rrethanë lehtësuese të merr pranimin e fajësisë premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla, është mbajtur i familjes edhe për kundër faktit se i njëjti nuk punon askund, sepse e ka shkallën e invaliditetit të përhershëm të aftësisë punuese prej 48%, dhe për këtë gjykatës ja dorëzon një kopje të asaj ekspertize atëherë në bazë të lartcekurave gjykata të ja shqiptoi një dënim sa më të lehtë.

I akuzuari P.G në fjalën përfundimtare deklaroi se mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij.

Avokatja Feride Xani në fjalën e saj përfundimtare deklaron se pas aprovimit të pranimit të fajësisë nga ana e gjykatës ku i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë në mënyrë të vullnetshme ka shprehur keqardhje, dhe është penduar ashtu siç e kam cekur edhe më lartë, andaj me rastin e marrjes së vendimit i propozon gjykatës që vet pranimin e gjykatës ta konsideroi si rrethanë lehtësuese e gjithashtu edhe faktin se i njëjti asnjë herë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, është mbajtës i familjes 7 anëtarësh, i gjendjes së dobët ekonomike, andaj nga të lartcekurat e lus gjykatën që të mbrojturin tim ti caktoi një dënim sa më të ultë.

I akuzuari I.B në fjalën përfundimtare deklaroi se mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij.

Gjykata me pranimin e fajësisë ne tërësi i ka vërtetuar këto gjendje faktike:

I pandehuri P.G Me dt**.**19.04.2018 rreth orës 20:00min,ne fsh.... K. Gjakovës, e përdor forcën fizike pa pëlqimin e te dëmtuarit/pandehurit I.B nga fsh.... K. Gjakovës, në atë mënyre qe derisa ishte i ndalur ne rruge me automjetin e tije i dëmtuari/pandehuri pas tij me automjet i bie burisë qe t'ia liroj rrugën, i pandehurit P me te shpejt del nga automjeti dhe e sulmon fizikisht ta godas por nuk arrin ndërsa i dëmtuarit/pandehurit qe te frikësojë nxjerr revolen e me te shtinë ne ajër dhe i ndërprenë sulmin.

Po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit I.B është vërtetuar se me pare ka siguruar e gjere me dt 19.04.2018 rreth orës 20.00min ne fsh.... K. Gjakovës, pa autorizim ka mbajtur arme e municion ne kundërshtim me nenin 4 prg.1 nen.prg1.1 te ligjit per arme R. Kosovës, të cilat me ligj kategorizohen si arme zjarri te ndaluara, dhe ate:1(një) Pistolete F.B. ..., modeli 35.Par,me nr. Serik ... kal.9mm,me (një) karikator dhe 3 (tre) fishek, ashtu qe gjate fjalosjes me te pandehurin P.G nga fsh.... K.Gjakove,qe te frikësoj nxjerr armen e me te shtënë ne ajër, e pas një raportimi arma i është gjetur me karikator dhe gëzhoja, e i është sekuestruar e gjenden ne dhomën e dëshmive ne Stacionin policor ne Gjakove.

2020:115469

Gjykata duke u kujdesur zyrtarisht në bazë të nenit 251 te KPPRK-ës nuk ka gjetur ndonjë prove të pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë në bazë te nenit 242 te KPPK-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bëre në mënyre vullnetare, me vetëdije të tij, andaj kjo gjykate ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit P.G janë formuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale, sulmi nga neni 187 par.1.te KPKP, gjykata ka konstatuar se i pandehuri është përgjegjës i veprës penale, ka qenë i vetëdijshëm për veprimet që i ka ndërmarrë, i ka dashur pasojat e shkaktuara me ato veprime, ka qenë përgjegjës në kohën e kryerjes se veprës penale, andaj gjykata ka vendosur dhe të pandehurin P.G e ka shpall fajtor për veprën penale për te cilën është akuzuar duke i shqiptuar dënimin me kusht me burgim me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues si në dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata po ashtu duke u kujdesur zyrtarisht në bazë të nenit 251 te KPPRK-ës nuk ka gjetur ndonjë prove të pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se i pandehuri I.B e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë në bazë te nenit 242 te KPPK-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bëre në mënyre vullnetare, me vetëdije të tij, andaj kjo gjykate ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit I.B janë formuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale, mbajtja ne pronësi, kontrolle ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 prg.1 të KPRK-së , gjykata ka konstatuar se i pandehuri është përgjegjës i veprës penale, ka qenë i vetëdijshëm për veprimet që i ka ndërmarrë, i ka dashur pasojat e shkaktuara me ato veprime, ka qenë përgjegjës në kohën e kryerjes se veprës penale, andaj gjykata ka vendosur dhe të pandehurin P.G e ka shpall fajtor për veprën penale për te cilën është akuzuar duke i shqiptuar dënimin me kusht me burgim me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues si në dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata në bazë të nenit 41 të KPK ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurve dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, dhe ne këtë mënyrë do te ndikoj ne arritjen e qëllimit të dënimit, te parandaloi kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të ndaloi persona tjerë nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqërorë për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata në bazë të nenit 73 lidhur me nenin 74 te KPK me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese, të cilat mund të ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimit ndaj të pandehurve

Rrethane lehtësuese për te pandehurin P.G ka marre pranimin e fajësisë dhe pajtimin ne mes palëve ndërsa si rrethanë renduese gjykata nuk e ka gjetur asnjë rrethanë.

Rrethane lehtësuese për te pandehurin I.B ka marre pranimin e fajësisë dhe pranimin ne mes palëve ndërsa si rrethanë renduese gjykata nuk e ka gjetur asnjë rrethanë.

Gjykate në bazë të nenit 58 të KPK-ës të pandehurve ju ka shqiptuar dënim me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovës sepse gjykata ka konsideruar se integrimi i të pandehurve në shoqëri është më i lehtë dhe më i mirë përmes mbikëqyrjes

2020:115469

nga shërbimi sprovës dhe i ka njoftuar të pandehurit se janë të obliguar që të mbaj kontakte me zyrtarët e shërbimit sprovues, e në rast se nuk mbajnë kontakte me zyrtaret e shërbimit sprovues gjykata do te revokoi dënimin me kusht.

Gjykata ne baze te nenit 374 para.3.KPK i ka konfiskuar armen konfiskohet arma: arma e llojit MP-57 me karikator–disk me numër serik 1600575,ne baze te dëftesës mbi konfiskimin e pronës me numër 2018-EA-354 të datës 19.04.2023,

Gjykata në bazë të nenit 452 te KPPK e ka obliguar te pandehurin që gjykatës ti paguaj paushallin gjyqësorë në shumë prej 30 euro ne afat prej 30 ditësh nga dita kur ky aktgjykim te marr formën e prere, ndërsa për shpenzimet e procedurës gjykata do të vendos me aktvendim të veçante.

Gjykata në bazë të nenit 36 paragraf 3 nën paragraf 3.2 LIGJI NR. 08/L-109 për kompensimin e viktimave e ka obliguar të pandehurin në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën 50 euro ne afate prej 30 ditëve duke filluar nga dita qe ky aktgjykim te merr formën e prere.

Duke u bazuar në të lartcekurat u vendos si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVE
PKR.nr.2018:063902. te dt.18.05.2023

Sekretarja juridike:
Nushe Kadrija

Kryetari i trupit gjykues:
Sulltan Dobraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, drejtuar Gjykatës se Apelit në Prishtinë përmes Gjykatës Themelore Gjakovë

2020:115469